



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13330/12 Prot

Fier, më 26/12 2024

V E N D I M

Nr. 144, Date 23.12 2024.

**“Për fillimin e procedurave të prishjes së objektit: Shkolla e vjetër 9-vjeçare
“ 5 Dëshmorët” në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier”**

Në mbështetje të nenit 54, gërma “k” të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.5.2015 të Keshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar si dhe nisur nga kërkesa nr. 12155 Prot., datë 20.11.2024 e Njesise Administrative Portez, lidhur me prishjen e objektit të shkollës së vjetër “5 Dëshmoret” në fshatin Patos Fshat, si pasojë e amortizimit të strukturës dhe ankesave të komunitetit për rrezikshmerinë që paraqet për jetën e banorëve, pasi ka dalë totalisht jashtë funksionit, referuar dhe Akt Ekspertimit Teknik të mbajtur nga grupi i punës i ngritur me urdher të Kryetarit të Bashkisë, për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese konstruktive dhe funksionale të objektit dhe relacionit të hartuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave të Bashkisë Fier, Drejtoria e Programimit dhe Kontrollit të Punëve Publike dhe Investimeve, kërkon nga Keshilli i Bashkisë të miratojë fillimin e procedurave të prishjes së objektit: Shkolla e vjetër 9-vjeçare “ 5 Dëshmorët”, ndodhur në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier.

- **Objekti është teresisht i amortizuar.**
- **Ai ka humbur perfundimisht funksionin e vet.**
- **Nisur nga shkalla e degradimit të këtij objekti, investimi që do të duhet për ta rehabilituar atë, nuk justifikon shfrytëzimin e tij.**

Për sa me sipër, Këshilli i Bashkisë;

VENDOSI:

1. Te miratojë fillimin e procedurave të prishjes së objektit: Shkolla e vjetër 9-vjeçare “5 Dëshmorët”, e ndodhur në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier.

2. Per vijimin e procedurave të mëtejshme për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkise Fier.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT
ANTONETA CUNAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE KONTROLLIT TE PUNEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE

Nr 13330/1

RELACION

dt. 17.12.2024

**“Për fillimin e procedurave të prishjes së objektit: Shkolla e vjetër 9-vjeçare
“5 Dëshmorët” në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier”**

Në mbështetje të nenit 54, shkronjat “dh” të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të Ligjit nr. 107, date 31.07.2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 408, datë 13.5.2015 të Keshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit””, i ndryshuar, nisur dhe nga kërkesa nr. 12155 Prot., date 20.11.2024 e Njesise Administrative Portez, lidhur me prishjen e objektit të shkollës së vjeter “5 Dëshmorët” në fshatin Patos Fshat, si pasojë e amortizimit të strukturës dhe ankesave të komunitetit për rrezikshmerinë që paraqet për jetën e banorëve, pasi ka dalë totalisht jashtë funksionit, si dhe referuar Akt Ekspertimit Teknik të mbajtur nga grupi i punës i ngritur me urdher të Kryetarit të Bashkisë, për inspektimin dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese konstruktive dhe funksionale të objektit dhe relacionit të hartuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave të Bashkisë Fier, Drejtoria e Programimit dhe Kontrollit të Punëve Publike dhe Investimeve kërkon nga Keshilli Bashkiak të miratojë fillimin e procedurave të prishjes së objektit: Shkolla e vjetër 9-vjeçare “5 Dëshmorët”, ndodhur në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier.

- **Objekti është teresisht i amortizuar.**
- **Ai ka humbur perfundimisht funksionin e vet.**
- **Nisur nga shkalla e degradimit të këtij objekti, investimi që do të duhet për ta rehabilituar atë, nuk justifikon shfrytëzimin e tij.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PRONAVE

Fier, më 16 . 12 . 2024

RELACION

Për vlerësimin e gjëndjes ekzistuese të objektit shkolla e vjetër 9-vjeçare “ 5 Dëshmorët”, ndodhur në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 901 date 21.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Portëz të Qarkut Fier”, dhe Vendimin nr 510 datë 10.06.2015 “ Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësiti e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo teritorial”, Bashkia Fier ka në inventar pronën me emertim, shkolla e vjetër 9-vjeçare “ **5 Dëshmorët**”, me nr inventari 78, ndodhur në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier.

Me shkresën me nr prot 942, datë 20.11.2024, protokolluar në Bashkinë Fier me nr prot 12155, datë 20.11.2024, Njësia Administrative Portëz I ka kërkuar Bashkisë Fier, prishjen e objektit shkolla e vjetër 9-vjeçare “ **5 Dëshmorët**”, ndodhur në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier. Kjo kërkesë vjen si pasojë e ankesës së komunitetit për rrezikshmërinë që paraqet për jetën e banorëve amortizimi I objektit në fjalë. Për sa më sipër si dhe në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të Ligjit nr .107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, I nryshuar, të Vendimit Nr.408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” I ndryshuar, Kryetari Bashkisë me Urdhër nr 612, datë 27.11.2014, ka ngritur grupin e punës për inspektimin dhe vlerësimin e gjëndjes ekzistuese konstruktive dhe funksionale të shkollës së vjetër “ **5 Dëshmorët**”, në fshatin Patos Fshat, Njësia Administrative Portëz, Fier. Në aktin e vlerësimit teknik të objektit, grupi i punës si përfundim ka nxjerë konkluzionin si më poshtë:

KONKLUZION

**MBI GJENDJEN EKZISTUESE KONSTRUKTIVE DHE FUNKSIONALE TE
GODINES SE ISH-SHKOLLES 9-VJEÇARE “5 DESHMORET”**

Grupi i punës sipas verifikimit në vend dhe në baze të përshkrimeve të bera me lartë nga kontrolli vizual për **GJENDJEN EKZISTUESE KONSTRUKTIVE DHE**

FUNKSIONALE TE GODINES SE ISH SHKOLLES 9-VJEÇARE “5 DESHMORET”
e ndodhur ne fshatin Patos Fshat, Nj. Adm. Portez, Bashkia Fier, konkludon se :

- **Objekti eshte teresisht i amortizuar.**
- **Ai ka humbur perfundimisht funksionin e vet.**
- **Si pasoje e elementeve mbrojtjes (suvatim dhe hidroizolim), si dhe demtimeve nga faktoret e jashtem, objekti ka shkuar drejt degradimit.**
- **Si pasoje e demtimit te elementeve strukturore (themele, murature, breza b/a, kolona rigjiduese dhe soleta) mund te ndodhi nje veteshembje spontane e tij (sidomos per shkaqe madhore si termete, shkarje terreni, permbytje etj,) duke rrezikuar jetet njerezore dhe shtazore.**
- **Nisur nga shkalla e degradimit te ketij objekti, investimi qe do te duhet per ta rehabilituar ate, nuk justifikon shfrytezimin e tij.**

Rekomandohet shembja dhe sistemimi i territorit te ketij objekti

Fier, me 11.12.2024

AKT EKSPERTIMI TEKNIK

MBI GJENDJEN EKZISTUESE KONSTRUKTIVE DHE FUNKSIONALE TE GODINES SE ISH-SHKOLLES 9-VJEÇARE “5 DESHMORET”

VENDNDODHJA:

Fshati: Patos Fshat
Njesia Administrative: Portez
Bashkia Fier

OBJEKTIVI

Ne kete akt ekspertimi do te jepet nje opinion profesional mbi gjendjen funksionale aktuale, skemen konstruktive, situaten e demtimeve te elementeve strukturore dhe riskun (nese ka) per shembje spontane (vete shembje nga humbja e qendrueshmerise, lokale apo totale) te godines se ish shkolles 9-vjeçare “5 Deshmoret” ne fshatin Patos Fshat.

DATA E KRYERJES SE EKSPERTIMIT

Objekti u inspektua ne daten 06.12.2024 nga grupi i inspektimit dhe raporti u pergatit me daten 11.12.2024. Inspektimi u krye ne zbatim te Urdhrit 612, date 27.11.2024 te Kryetarit te Bashkise Fier, protokolluar me nr. 12442, date 27.11.2024 “Per veleresim te gjendjes ekzistuese te objektit te shkolles se vjeter 9-vjeçare “5 Deshmoret” ne fshatin Patos Fshat, nj.ad. Portez, Bashkia Fier”.

PERSHKRIM I PERGJITHSEM

Objekti ndodhet ne anen veri-lindore te fshatit Patos Fshat, ne nje terren kodrinorme pjerresi te konsiderueshme. Eshte nje godine 2 kateshe e ndertuar ne fundin e viteve '70 (referuar formes, tipit te elementeve konstruktive dhe materialeve ndertimore te perdorura).

Hyrja kryesore eshte nga perendimi. Shkallet per ne katin e pare jane vendosur prane hyrjes kryesore.

Per shkak te pjerresise se terrenit, ne anen perendimore, objekti eshte vendosur rreth 80cm mbi kuoten e tokes natyrore, kurse ne anen lindore eshte thujse ne kuoten e tokes natyrore.

Ne anen veriore eshte realizuar nje shtese e mevoneshme 2 kateshe per shtese ambjentesh (ndoshta per kopsht femijesh) e cila ka hyrje te veçante.



GODINA E ISH-SHKOLLES

PERSHKRIM I ELEMENTEVE KONSTRUKTIVE

Objekti është një godine dy kateshe me strukture mbajtëse **murature tulle**. Trashësia e muratës është 25cm. Për konstruksionin e muratës janë përdorur tulla të tipeve të ndryshme: kryesisht **tulle silikate (kryesisht në katin përde dhe pak në katin e për)**, në pjesë të caktuara, në sasi më të vogël **tulla të plota vendi** dhe në pjesën dominuese të muratës së katit të për **tulla mbajtëse të lehtësuara**.

Në muraturë, në pjesë të caktuara, janë aplikuar **breza b/a** mbi të cilat mbështeten soletat. Nuk mund të shprehemi për llojin e betonit dhe armaturën e çelikut të këtyre brezave (në kohën kur është ndërtuar objekti përdorej kryesisht beton M-150 dhe çelik vendi i lemuar).

Në disa prej këndeve të objektit dallohen **kolona rigjduese b/a** me seksion terthor 25x25cm. Nuk ka të dhëna për llojin e betonit dhe armaturën e çelikut të këtyre kolonave.

Ndarja e kateve dhe mbulimi është realizuar me soleta b/a. Soletat janë të tipit **SP (soleta të parandëruara)** me trashësi 16cm dhe gjëresi 88cm. Mbështetja e soletave bëhet kryesisht në drejtimin lindje-perëndim.

Themelet janë të tipit **rigjide të vazhduara** me material guri. Nuk ka të dhëna për gjëresinë, thellësinë e zhytjes së themeleve dhe llaçin e përdorur si material lidhës.

Të gjitha të dhënat e mësipërme për anën konstruktive janë marrë vetëm nga një vëzhgim i jashtëm i elementeve konstruktive.

PERSHKRIMI I GJENDJES STRUKTURORE

Gjate inspektimit u kontrolluan vizualisht: gjendja e elementeve strukturore vertikale (muret) dhe gjendja e elementeve strukturore horizontale (breza b/a, soleta beton arme). Kontrolli u krye me qellim evidentimin e demtimeve, shembjeve, plasaritjeve dhe çedimeve të dukshme që mund të ishin krijuar në objekt. Nga inspektimi u vërejt që gjendja e elementeve ishte tejte e amortizuar.

Godina ka qene e suvatuar nga jashte por aktualisht pjesa me e madhe e suvatimit eshte e shkaterruar.

Në objekt mungojnë teresisht dyert dhe dritaret. Mungesa e suvatimit të jashtëm, hidroizolimit dhe e dyerve e dritareve ka sjelle si pasoje degradimin e muratës mbajtëse të tullës dhe të elementeve beton/arme: brezave, kolonave dhe të soletave. Në pjesë të të madhe (fasada perëndimore dhe fasada lindore) muratura është e prishur.

Sipas të thenave të banoreve objekti është abandonuar si pasoje e demtimeve nga rreshkitja e terrenit të ndodhur disa vite më parë.

Objekti aktualisht nuk shfrytëzohet për qëllimin për të cilin është realizuar (është ndërtuar një godinë e re për shkollën) dhe terreni rreth tij është i pasistemuar dhe i mbuluar nga bimesia.

Objekti shfrytëzohet nga banoret e zonës si vend magazinimi dhe për strehim bagetish.

KONKLuzion


MBI GJENDJEN EKZISTUESE KONSTRUKTIVE DHE FUNKSIONALE TE GODINES SE ISH-SHKOLLES 9-VJEÇARE “5 DESHMORET”




Grupi i punës sipas verifikimit në vend dhe në baze të përshkrimeve të bera më lartë nga kontrolli vizual për **GJENDJEN EKZISTUESE KONSTRUKTIVE DHE FUNKSIONALE TE GODINES SE ISH SHKOLLES 9-VJEÇARE “5 DESHMORET”** e ndodhur në fshatin Patos Fshat, Nj. Adm. Portez, Bashkia Fier, konkludon se :

- **Objekti është teresisht i amortizuar.**
- **Ai ka humbur perfundimisht funksionin e vet.**
- **Si pasoje e elementeve mbrojtës (suvatim dhe hidroizolim), si dhe demtimeve nga faktoret e jashtëm, objekti ka shkuar drejt degradimit.**
- **Si pasoje e demtimit të elementeve strukturore (themele, murature, breza b/a, kolona rigjiduese dhe soleta) mund të ndodhi një veteshembje spontane e tij (sidomos për shkaqe mëdha si termete, shkarje terreni, permbytje etj.) duke rrezikuar jetet njerëzore dhe shtazore.**
- **Nisur nga shkalla e degradimit të këtij objekti, investimi që do të duhet për ta rehabilituar atë, nuk justifikon shfrytëzimin e tij.**

Rekomandohet shembja dhe sistemimi i territorit të këtij objekti

• FOTO TE OBJEKTIT





Grupi i Punes:

F